

Tiranë, më .04.2022

KËRKUES: Saimir Tahiri, i biri i Bashkimit, dhe i Luizës i datëlindjes 03.10.1979, lindur dhe banues në Tiranë, aktualisht duke vuajtur dënimin në IEVP Fier..

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit me burgim, dhënë me Vendimin nr.03, datë 04.02.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 417 pika 1 dhe 476 pika 1 „gërma “c” germa”c” të Kodit të Procedurës Penale.

drejtuar

**GJYKATËS SË LARTË
KOLEGJIT PENAL**

TIRANË

I nderuar Z.Kryetar !

Te Nderuar Zotërinj Gjyqtarë!

Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në rigjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit Saimir Tahiri, me Vendimin Nr.03, datë 04.02.2022, ka vendosur:

- 1. Lënien në fuqi të Vendimit , Nr. 60, datë 19.09.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me ndryshimin si më poshtë:***
- 2. Moszbatimin e nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurin z.Saimir Tahiri.***
- 3. Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin z.Saimir Tahiri fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.***

Mbas ushtrimit të së drejtës së rekursit, bazuar në nenet 417 dhe 476 pika 1 gërma “c” të K.Pr.P. paraqesim këtë kërkesë me objekt : ***Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr.03, dt 04.02.2022***, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Tiranë, për arsyet e mëposhtëme.:

Gjykata e Posaçme e Apelit Tiranë ka marë në shqyrtim gjatë rigjykimit Vendimin Nr.60, datë 19.09.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda që ka vendosur:

- 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Saimir Tahiri për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.***
- 2. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Saimir Tahiri për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë të K. Penal , pasi nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale që akuzohet, bazuar në nenin 388, pika 1, gërma d, të K.Pr.P.***
- 3. Në bazë të nenit 406 paragrafi i parë të K.PR.P, të pandehurit Saimir Tahiri, për shkak të gjykimit të shkrutuar, i ulet një e treta e dënimit me burgim dhe dënohet përfundimisht me 3 (tre) vjet e (katër) muaj burgim.***
- 4. Bazuar në nenin 59 të K. Penal, udhëzohet pezullimi i vuajtjes së dënimit me burgim për të pandehurin Saimir Tahiri dhe vënien e tij në provë për një afat prej 3 (tre) vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryej vepër tjetër penale, duke urdhëruar që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës.***
- 5. Heqjen e së drejtës të pandehurit Saimir Tahiri për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 3 (tre) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi i dytë të K. Penal, zbatimi i të cilit fillon me marrjen formë të prerë (i ekzekutueshëm) të këtij vendimi, meqënëse është pezulluar vuajtja e dënimit me burgim.***

Gjykata e Posaçme e Apelit e ka ndryshuar këtë vendim vetëm persa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit duke vendosur moszbatimin e nenit 59 të Kodit Penal që ka pezulluar vuajtjen e dënimit me burgim të të dënuarit Saimir Tahiri.

Vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është vënë në ekzekutim menjëherë në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të

shtetasit Saimir Tahiri, pa respektuar procedurën ligjore.

Duke parashtruar se në rastin konkret vuajtja e menjëhershme e dënimit me burgim e të pandehurit Saimir Tahiri, mund të spajllë pasoja të rënda për vetë të pandehurin si dhe për familjen e tij.

Kështu, Z.Tahiri ka mbajtur funksionin e ish Ministrit të Brendëshëm të Republikës së Shqipërisë ai rrezikon dhe mund të bëhet objekt i personazheve të krimit që ndodhen duke kryer dënimin në IEVP Fier. Nga ana tjetër edhe familja e tij gjendet e ekspozuar ndaj pasoja të mundshme.

Nga rekursi bashkëlidhur është e qartë që vendimi nr.03, datë 04.03.2022 i Gjykatës së Posaçme të Apelit është një vendim i marrë në shkelje flagrante të ligjit sa i përket procesit të rregullt ligjor dhe vijimi i ekzekutimit të tij çënon rëndë jo vetëm interesat e të dënuarit Saimir Tahiri, por edhe të drejtësisë.

Në këto rrethana ndodhemi përpara kushteve dhe rrethanave të parashikuara në gërmën “c” pika 1 të nenit 476 të K.Proçedurës Penale ku parashikohen rastet e shtyrjes se ekzekutimit të vendimit dhe ne referencë të të pikës 1 të nenit 417 të K.Proçedurës Penale, kërkojmë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që sa më sipër mbasi të shqyrtojë këtë kërkesë të vendosë.

Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 03, datë 04.02.2022 të Gjykatës së Posaçme te Apelit Tiranë për të dënuarin Saimir Tahiri.

***Me Konsideratë
A V O K A T***